

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Saktësia / *el-Waktu* / الْوَقْتُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

ثُمَّ جِئْتَنَا عَلَىٰ قَدَرٍ يَا مُوسَىٰ

“...Pastaj ti erdhe në kohën e caktuar, o Musa.” (Ta-He, 40)¹

El-Wakt (koha)² është një emër për kufij kohor.³ Në këtë kontekst, ky është një emër për tri kuptime në tri nivele.

Kuptimi i parë është ajo që ndodh gjatë një euforie shpirtërore (*wexhd*) të vërtetë, e cila del nga përjetimi i:

- Shkëlqimit të hirit të cilin e sjell shpresa e kulluar
- Goditjes së shkaktuar nga frika e vërtetë
- Zjarrmisë së mallit të shkaktuar nga dashuria e flaktë⁴

¹ Arsyeja përse shejhu (el-Harawi) zgjodhi këtë ajet është se ajeti tregon se çdo gjë ka të caktuar kohën e duhur.

² *Wakt* në kuptimin e sipërfaqshëm do të thotë kohë. Këtu, ky emërtim ka të bëjë me saktësinë. Kjo nënkupton shumë gjëra në këtë kontekst: gatishmërinë dhe bërjen e gjërave në kohën e duhur (më të përshtatshme); të qenët i vërtetë në të jetuarit e plotë në çastin e tanishëm, duke mos lejuar të kaluarën a të tashmën të ta heqë vëmendjen nga e tanishmja dhe duke zënë të shumtën e saj. Në shtegun e pastrimit shpirtëror (*tezkijeh*), kjo, me siguri, nuk merret sipas kuptimit hedonist, por merret në kuptimin devocional të përsosurisë (*ihsaan*) së veprimit më të përshtatshëm për atë çast.

³ Mu si vendi për materie në një automjet, koha është një automjet për ngjarjet. Koha është marrëdhënie mes dy ngjarjeve. Në kontekstin e Tesawufit, kjo i përket çastit a gjendjes së tanishme ose planit hyjnor.

⁴ Vërej sesi në këtë nivel ai ia nënshtroi çastin e ndjekësit ndjenjave të shpresës, të frikës, dhe të dashurisë.

Kuptimi i dytë i përket shtegut të pastrimit shpirtëror të një ndjekësi që lëviz mes vendosjes në shkallë dhe paqëndrueshmërisë⁵ në to, ndonëse ai gjendet më afër vendosjes, duke përshkuar rrugën e gjendjes shpirtërore (*haal*) dhe duke i kushtuar vëmendje dijes.⁶ Kështu, atë nganjëherë e preokupon dija, nganjëherë e zhvendos gjendja. Dilema e tij përballë dijes dhe gjendjes e bën atë që:

- Të shijojë⁷ të parët në një fazë
- Të kaplohet nga xhelozia⁸ në një fazë tjetër
- Të shohë njollën e shkapërderdhjes në një fazë tjetër⁹

⁵ Vendosja i referohet gjendjes së bashkimit me Allahun dhe të parit të njësisë së origjinës dhe të Shkakut të Parë, Kontrolluesit të gjithëfuqishëm të të gjitha gjërave. Paqëndrueshmëria është gjendja e atij që u përgjigjet kërkesave të ndryshme në kohë të ndryshme dhe kërkesave përkatëse të atyre kohëve.

⁶ Shejhu (el-Harawi) mendoi të thoshte se personi që i kushtohet vendosjes (në shkallë) më shumë e ka për gajle gjendjen shpirtërore (*haal*). Ky kuptim është i pranueshëm. Gjendja shpirtërore (*haal*) është objektivi, ndërsa dija është mjeti për arritjen e tij. Mirëpo, siç thekson Ibn el-Kajjim në *Medaarixh*, s'ka nevojë të krijohet konflikt mes gjendjes (*haal*) dhe dijes (*ilm*). Ndërsa janë sinonime dhe përfshijnë njëra-tjetrën, këto dyja nuk bien ndesh me njëra-tjetrën. Përkundrazi, gjendja e mirë nxit ndjekësin të mësojë për Zotin dhe kënaqësitë e Tij, ndërsa dija e mirë e motivon të kujdeset për zemrën e tij, të pastrojë të brendshmen dhe të kërkojë me zell t'i afrohet Zotit të tij.

⁷ Të parët e shfaqjeve hyjnore nëpërmjet *texhel'li* (manifestimeve) të cilësive dhe veprimeve të Tij.

⁸ Xhelozia ndaj atyre që e tejkalojnë në *haal* (gjendjen e arritur).

⁹ Preokupimet e ndryshme mund t'ia prishin personit vëmendjen dhe qetësinë. Ndryshueshmëria në shërbimin ndaj Zotit, me veprimet më të pëlqyera nga Ai në kohë të ndryshme, është një virtyt. Ebu Hurejra përcolli se peygamberi ﷺ tha: "Kush prej jush është duke agjëruar sot?" Ebu Bekri tha: "Unë." Ai pyeti prapë: "Kush prej jush ka përcjell një funeral sot?" Ebu Bekri tha: "Unë." Ai pyeti prapë: "Kush prej jush ka ushqyer ndonjë të pangrënë sot?" Ebu Bekri tha: "Unë." Ai pyeti prapë: "Kush prej jush ka vizituar ndonjë të sëmurë sot?" Ebu Bekri tha: "Unë." Atëherë, i Dërguari i Allahut tha: "Ai në të cilin bashkohen këto (vepra të mira), do të hyjë në xhenet." (Muslim)

Mirëpo, paqëndrueshmëria mund të çojë në shkapërderdhje dhe humbje të përqendrimit shpirtëror i cili bën që të përthithesh nga prania hyjnore, gjë që shejhu (el-Harawi) e konsideron si qëllim përfundimtar. Personi duhet të shmangë shkapërderdhjen dhe shpërqendrimin çdo herë duke qenë gjithnjë i vëmendshëm për Zotin dhe duke kujtuar Atë. Pavarësisht nga ngjyrat dhe copat e tij të ndryshme, një mozaik konsiderohet të jetë i plotë, nëse ka një temë të vetme. Atëherë, që të bësh bashkim (*xhem'*) me Allahun në ndryshueshmërinë (*ferk*) e angazhimeve, le të jetë tema e jetës sate:

Kuptimi i tretë: Ata thanë “Koha është i Vërteti”. Me këtë, ata menduan në përthithjen e formës së kohës në realitetin e të Vërtetit. Për sa më përket mua (Hatim el-Haxh), mendoj se është tejet vështirë që ky kuptim t’i vishet këtij emri. Sidoqoftë, në këtë kuptim të tretë, ky emër i vihet zhdukjes së formave jo në realitet, por në zbulim (perceptim).¹⁰ Kjo është përtej Shkrepëtimës (*berk*) dhe Ekstazës (gjetjes së gëzimit shpirtëror). Po të vazhdonte, kjo do të ishte më afër shkallës ose stacionit të bashkimit. Ndërsa nuk arrin luginën e realitetit (*wuxhuud*)¹¹, kjo:

- Të kursen nga barrosja me shërbim¹²
- Dëlir dialogun intim¹³
- Të lë të ndiesh aromën e realitetit (*wuxhuud*).¹⁴

“Vërtet, namazi im, kurbanii im, të jetuarit tim dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve.” (el-En’am, 162)

¹⁰ Në këtë fazë, të cilën shejhu (el-Harawi) zakonisht ia kushton asgjësimin të egos, çasti zhduket, kur të perceptohet në kontekstin e përjetësisë së të Vërtetit.

¹¹ Një emër për shkallët më të larta ku Realiteti gjendet në aktualitet.

¹² Mënyra e duhur për ta kuptuar këtë është se kjo e bën shërbimin (adhurimin) të lehtë dhe të kënaqshëm, duke larguar kështu nevojën për durim dhe duke dhënë energji e gëzim.

¹³ Kur dialogu i personit me Zotin e tij nuk priset nga ndonjë shpërqendrim.

¹⁴ *Wuxhuud* është shkalla ose stacioni i 96-të në këtë libër.